



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:173325
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05776026

C.nr. 1601/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K. K. D. F. E. E., të cilin e përfaqëson A.M., sipas autorizimit, kundër të paditurit H.L., me vendbanim në fshatin “T.”, Komuna P., të cilin e përfaqëson A.R., avokat nga P., sipas autorizimit, me bazë juridike kompensim dëmit material, vlera e kontestit 1.899.88 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurit, në seancë publike, të datës 15.05.2024, mori, ndërsa me datën 30.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit K. K. D. F. E. E., me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri H. L., nga Komuna P., që paditësit K. K. D. F. E. E., në emër të kompensimit të dëmit material të ia paguaj shumën prej 1.899.88 euro dhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 20 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh me kërcënimin e përmbarimit, **SI E PABAZUAR.**

II. DETYROHET paditësi K. K. D. F. E. E., që të paditurit H. L., nga Komuna P., që në emër të shpenzimeve të procedurës, të ia paguaj shumën prej 270 euro, në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 09.12.2020 ka parashtruar padi në gjykatë ndaj të paditurit H. L., me vendbanim në fshatin T., Komuna e P., me bazë juridike kompensim i dëmit material, vlera e kontesti 1.899.88 euro.

Në padi, gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuar i palës paditëse ka deklaruar se këtu i padituri ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar e që është vërtetuar edhe me Aktgjykim penal P.nr.../16, i plotfuqishëm me datën 04.09.2017, me këtë Aktgjykim K... është udhëzuar përmes këshillës juridike për kontest civil, për të

kërkuar demin pasuror-juridik të shkaktuar përmes veprës penale, dëm i cili është kërkuar me padi dhe është kalkuluar sipas procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, ku për konsumatorët komercial, pra jo-familjar duhet te pasur parasysh se i njëjti sipas nenit 13 të kësaj procedure, kalkulimi behet retroaktiv për 12 muaj, e llogaritja behet sipas nenit 15 të kësaj procedure, qe janë shkuar ne procesverbal, ku i njëjti ka qene duke e keqpërdorur energjinë elektrike, pra ky kalkulim është bere sipas procedurave ligjore si dhe demi i shkaktuar kundër paditësit është si ne vlerën e përshkruar si në padi, si në baze të faturës DPE 14 HP ..., ku në shumen prej 1899.88, sa i përket pretendimeve të paditurit, të njëjtën e kundërshtojmë sepse me nenin 361 të LMD-së. Tutje ka shtuar se këtu i padituri e ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në mënyrë të pa autorizuar të vërtetuar me Aktgjykim penal me numër P.nr..../16, i plotfuqishëm me datën 04.09.2017, ku i padituri e ka pranuar fajësinë për veprën penale, vjedhje e shërbimeve komunale dhe në bazë të kësaj K..., është udhëzuar në kontest civil, për të kërkuar demin pasuror-juridik të shkaktuar përmes veprës penale. Dëmi i cili është kërkuar me padi dhe është kalkuluar sipas procedurës për identifikimin dhe parandalimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, për konsumatorët familjar, duke pasur parasysh qe i paditur është konsumator familjar, pra të njëjtit sipas nenit 13 të kësaj procedure, kalkulimi behet prej 6 muaj retroaktiv, e llogaritja behet në baze të nenit 15, duke iu kalkuluar në bazë të pajisjeve elektrike, qe janë te cekura ne procesverbalin, ku ekipa e K...i ka gjetur atë dite, kur është keqpërdor energjia elektrike, pra ky kalkulim është bere konform procedurave ligjore dhe rregulloreve ne fuqi, dëmi i shkaktuar këtu paditëses është si në vlerën e kërkuar në padi, ku e kemi bashkangjitur dhe faturën, me nr. DPE 14HP..., të datës 24.12.2014, ne shumën prej 1899.88 Euro, andaj kërkojmë nga Gjykata që duke u bazuar ne nenin 361 të LMD-së, pika 1 e këtij neni ku thotë së të gjitha kërkesat qe janë të vërtetuara me vendim të formës se prere të Gjykatës apo vendim të organit tjetër kompetent, parashkruhen për 10 vite, madje edhe për ato qe Ligji parashikon afat me te shkurtër për parashkrim, andaj kërkojmë nga Gjykata qe te aprovoj ne tërësinë padinë dhe ta detyroj të paditurin qe në emër të kompensimit te demi ta paguaj shumen prej 1899.88 euro me kamat ligjore si ne petitiumin e padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë vetëm në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.

I padituri, në përgjigje në padi, në seancat e mbajtura, dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkojmë nga Gjykata që të veproj sipas nenit 391 të LPK-së. Nuk është kontestuar se ekziston Aktgjykimimi penal i plotfuqishëm por e vërteta edhe siç ligji dikton, padia është paraqitur pas skadimit të afatit, pasi qe dispozitat e nenit 358 të LMD-së, janë të çarta, këtu përfaqësuesi i paditësit e pranoj së dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe pikërisht kjo e lidh me dispozitën e nenit 358 të LMD-së, me lejoni të përkujtoj nenin 462 të KPPRK-së, par.1 për kërkesën pasurore-juridike vendos Gjykata, par.2 me Aktgjykim me te cilën i pandehuri shpallet fajtor, Gjykata mund të vendos për kërkesën pasurore-juridike te palës së dëmtuar ne tërësi, pjesërisht, dhe për pjesën e mbetur e udhëzon për kontest civil. Kur te dhënat i mbledhura ne procedurën penale nuk paraqesin bazë të sigurt, për gjykim të plotë e as te pjesshëm, Gjykata e udhëzon të dëmtuarin qe tere kërkesën pasurore-juridike mund të realizoj ne procedurë të kontestit civil. Ashtu që konsiderojmë së në shqyrtimin paraprak të padisë, duket te hedhet

poshtë padia, si e pa afatshme, duke u bazuar në parimin e ekonomizimit. Vepra penale për te cilin është shpall fajtor i padituri, parashkrimi i veprës penale është 3 vite, andaj brenda kësaj periudhe kohore prej 3 viteve, ligji ja ka mundësuar të paraqes kërkesë për dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar me vepër penale, për te cilën me Aktgjykim penal është shpall fajtor dhe e ka krijuar pala e paditur, për realizim të dëmit. Tutje ka shtuar se mbetem ne tërësi pranë përgjegjës ne padi, me te cilën i kemi dhëne arsyet për çka e konsiderojmë së padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar për faktin së kërkesa është e përfshirë ne parashkrim, i autorizuari i palës paditëse edhe ne fjalën përfundimtare e konfirmoj se kërkesa për kompensim e dëmit është e shkaktuar me vepër penale, sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm te kësaj Gjykate, P.nr....., dhe nga kjo provë e administruar u vërtetua se Aktgjykimi ka marr plotfuqishmërisë e formën e prere me datën 04.09.2017, kurse padia është parashtruar ne gjykate me datën 09.12.2020, pas afatit 3 vjet, për te cilën paditësi ka pasur mundësinë ligjore për të ushtruar padi për kompensim dëmi, andaj, Gjykatës i propozojmë që në bazë të dispozitave të përshkuara ne përgjigjen ne padi të merr Aktgjykimi me te cilën do të hedhë poshtë- apo refuzoj si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për 2 seanca në shumën prej 270 euro, sipas tarifës se OAK-së.

Vërtetimi i gjendjes faktike

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata me propozimin e palëve ndërgjyqëse bëri administrimin e provave si: Leximi i aktgjykimi P.nr.../16, i datës 08.08.2017, i plotfuqishëm me datës 04.09.2017, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë; leximi i faturës e lëshuar nga KESCO, me numër DPE 14HP.... e datës 24.12.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar.

Nga provat shkresore të administruara si dhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa kontestuar se pala e paditur sipas aktgjykimin penal P.nr.../16, i datës 08.08.2017, i cili e ka marrë formën e prerë me datën 04.09.2017, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, ishte shpallur fajtor për veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet çështja e parashkrimit të kërkesës së palës paditëse, e që palët ndërgjyqëse lidhur me këtë pikë kishin pikëpamje të ndryshme.

Nga aktgjykimi penal i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, me numër P.nr.../16, i datës 08.08.2017, i plotfuqishëm nga data 04.09.2017, gjykata gjeti se i padituri H.L., ishte shpallur fajtor për veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, për shkak

se i njëjti me datë 18.12.2014 në shtëpinë e tij në fshatin T. Komuna e P., pa autorizim të furnizuesit të autorizuar është lidhur në përçuesin e energjisë elektrike, në mënyrë që ditën kritike përgjatë kontrollit që kanë bërë komisioni i autorizuar i KEDS është konstatuar se i pandehuri me qëllim vjedhje është furnizuar jashtë njehsorit me kabëll tokësore prej 4x35 mm, ç'rast dëmtuarës i ka shkaktuar dëmin material në shumë prej 1.899.88 euro. Ndërsa pala e dëmtuar këtu pala paditëse ishte udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontestin civil.

Nga fatura me numër DPE 14HP...., e datës 24.12.2014 e lëshuar nga KESCO, gjykata gjeti se lartësia e dëmit që i është shkaktuar paditësit, është kalkuluar në vlerë prej 1.899.88 euro.

Baza Ligjore

Gjykata, vlerëson së për rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat ligjore të *Ligji Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet E Detyrimeve (tutje LMD)*.

Neni 136 par.1 i LMD-së parasheh se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Neni 137 i LMD-së parasheh se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*.

Neni 341 i LMD-së parasheh se: *“1. Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit; 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit; 3. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë”*. Ndërsa neni 357 par. 1 dhe 2 i LMD-së parasheh se: *“1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin dhe 2. Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit”*.

Vlerësimi i Gjykatës

Pretendimet lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë.

Për gjatë procedurës, i padituri si në përgjigje në padi po ashtu edhe në seancat gjyqësore pretendimi i tij kryesor ishte së kërkesa e paditësit për kompensim dëmi është e përfshirë në parashkrim, të cilin pretendim gjykata bazuar në dispozitat e lartcekura e ka vlerësuar dhe ka ardhur në përfundim së pretendimi i të paditurit në këtë çështje juridike kontestimore është i bazuar. Gjykata vlerëson se paditësi ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit material nga i padituri duke filluar nga data 04.09.2017, përkatësisht nga data 17.08.2017 (përkatësisht data e pranimit të aktgjykimit nga pala paditëse sipas vulës së protokollimit), ngase nga kjo datë rezulton se paditësi është njoftuar për palën dhe dëmin e shkaktuar si dhe udhëzuar për dëmin e shkaktuar dhe rrjedhimisht ka lindur e drejta e tij për të kërkuar kompensim e dëmit. Mirëpo nga padia e paditësit rezulton se paditësi, padinë në këtë gjykatë e ka paraqitur me

datën 09.12.2020, përkatësisht pas kalimit të afatit prej 3 vitesh. Andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur përkatësisht nga neni 357 par.1 të LMD-së, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e përfshirë në parashkrim. Gjykata, shton faktin se në rastin konkret ka aplikuar dispozitën ligjore përkatësisht nenin 357 par.1 të LMD-së (afati subjektiv), duke pasur parasysh faktin se paditësi është njoftuar për personin i cili ka shkaktuar dëmi që nga periudha përkatësisht data 17.08.2017 (datë e pranimit të aktgjykimit) dhe jo sipas dispozitës përkatësisht nenit 357 par.2 të LMD-së i cili është afat objektiv dhe i njëjti vlen në rastet kur pala paditëse nuk ka njohuri për personin apo dëmin e shkaktuar, por megjithatë meqenëse është tejkaluar afati subjektiv, gjykata vlerësoi se në rastin konkret nuk mundet të aplikohet paragrafi 2 sipas dispozitës së nenit 357 të LMD-së.

Sipas nenit 342 par.1 të LMD-së: *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër.”*. Neni 358 par. 1 i LMD-së rregullon: *“1. Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.”*. Lidhur me aplikimin e kësaj dispozite në rastin kontestues, gjykata vë në dukje se në rastin konkret nuk mund të zbatohet kjo dispozitë për faktin se procedura penale e zhvilluar ndaj palës së paditur ka përfunduar më aktgjykim meritore përkatësisht sipas aktgjykimit penal P.nr.200/16, i datës 08.08.2017, i plotfuqishëm me datën 04.09.2017. Por sido që të jetë, ka kaluar koha e parashkrimit edhe në kuptim të kësaj dispozite.

Sipas nenit 369 të LMD-së: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.”*. Gjykata gjen se paditësi nuk i ka prezantuar gjykatës asnjë provë apo fakt, i cili do të kishte rëndësinë vendimtare të ndërprerjes së afatit të parashkrimit, që rrjedhimisht do të përbënte shkak që koha e kaluar e parashkrimit të mos llogaritet dhe që parashkrimi të ri-fillonte. Pretendimi i palës paditëse se në rastin konkret kërkesa e tij për kompensim dëmi nuk është e përfshirë në parashkrim sepse në rastin konkret meqenëse e kemi aktgjykimin P.nr. 200/16, i datës 08.08.2017, i plotfuqishëm me datën 04.09.2017, vlen dispozita ligjore përkatësisht sipas nenit 361 par.1 të LMD-së i cili nen parasheh se: *“Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”*, gjykata vlerëson se dispozitat e lartcekur ligjore në rastin konkret nuk mund të aplikohet ngase kërkesa e palës paditëse për kompensim dëmi, nuk është ende kërkesë e cila është e vërtetuar para organit gjyqësor apo ndonjë organi tjetër kompetent, përkatësisht sipas aktgjykimit penal P.nr.200/16, i datës 08.08.2017, i plotfuqishëm me datën 04.09.2017, del se për kërkesën e palës së dëmtuar tani paditësit, gjykata nuk ka vendosur, por që i njëjti është udhëzuar që kërkesën e tillë ta realizoj në procedurë civile. Gjykata vlerëson se dispozitat ligjore në të cilën është thirr pala paditëse, do të vinte në shprehje vetëm atëherë kur kërkesa për kompensim e dëmit të palës paditësit siç është në rastin konkret të vërtetohej qoftë nga ana e gjykatës apo organi tjetër kompetent,

përkatësisht, atëherë nga dita e plotfuqishmërisë së atij vendimi fillon të rrjedhë afati i parashkrimit edhe për këtë lloj të kërkesave, të cilat ndryshe quhet edhe kërkesa të vërtetuara nga gjykata ose organet e tjera kompetente.

Gjykata me rastin e vendosjes mori për bazë të gjitha provat e tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor mirë po të njëjta nuk kishin ndikim që të vendoset ndryshe.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të LPK-së përkatësisht në dispozitat ligjore të nenit 449 par.1 i cili para sheh se: *“Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor”* e lidhur me nenin 463 par. 1 dhe 2 i cili parasheh se: *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”* dhe *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”*, e lidhur me nenin 452 dhe 453 të po të njëjtit ligj, e në lidhshmëri me tarifën e OAK-së, duke marrë parasysh suksesin e palëve ndërgjyqëse në këtë procedurë, lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të palës së paditur dhe atë: për dy seancat e mbajtura (135.20 x 2), por meqë kërkesë e palës së paditur ishte në shumën prej 270 euro, gjykata konform nenit 2, par. 1 të LPK-së, i cili parasheh se: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*, vendosi shumë prej 270 euro.

Nga arsyet e cekura si më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK - së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1601/20, me datë 15.05.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.